



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJË
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE**

B.Curri më 18.01.2018

SHPLLJE

**PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË
KATEGORINË EKZEKUTIVE**

(Specialistë-Finance)

Niveli minimal i diplomës “Master profesional”

Në shkenca ekonomike

Kategoria e pagës lidhja nr.5 kad.IV-a

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Tropoje shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

Kërkohet 1 (nje) Specialistë finance në Drejtorinë ekonomike, në Bashkin Tropojë-Kategoria VI-a. Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele .

Vetëm në rast se këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë vakante, atëherë janë të vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë .

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave për **LEVIZJE PARALELE: 29.01.2018**

Afati për dorëzimin e dokumentave për **PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 02.02.2018**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

Implementimi dhe zbatimi i procedurave të lidhura me veprimet që gjenerojnë shpenzime dhe /ose të ardhura dhe garantimi i përputhshmërisë me ligjin.

- 1-Zbatimi i buxhetit vjetor në institucion dhe të gjitha vendimeve financiare .
- 2-Regjistrimi i të ardhurave.
- 3-Regjistrimi të shpenzimeve sipas ligjit brenda vitit financiarë.
- 4-Mbajtja e inventareve.
- 5-Kontrolli i magazinës, arkës dhe lëvizja e vlerave monetare dhe materiale në përputhje me dokumentacionin përkatës dhe me legjislacionin në fuqi.
- 6-Ndjekja dhe llogaritja e të gjitha shpenzimeve të institucionit sipas zërave të buxhetit
- 7-Kryen punë specifike të sektorit e buxhetit e financës brenda rregullave,ligjeve dhe udhëzimeve të përgjithshme lidhur me afatet perfundimtare te detyrave.
- 8-Pergjigjet para pergjegjsit te sektorit Buxhetit e finances per menaxhimin e çështjeve qe lidhen me e asetet,shpenzimet apo te ardhurat .
- 9-Realizon detyrat në përputhje me politikat e institucionit me standartet administrative dhe procedurat teknike,si dhe duke mbajtur parasysh praktikat më të mira profesionale.
- 10-Përgatit ne koh dhe me cilsi matrialet dhe informon ne kohe eproret per keto matrialet
- 11-Pregatit raporte periodike dhe informon eproret për ecurin e punës në fushen e pagave dhe gjendjes e sistemimit arkivit financës
- 12-Zbaton Rekomandimet apo sugjerimet e eproreve me qëllim përmirësimin e praktikave apo procedurave , në fushen e tatim taksa .
- 13-Diskuton rezultatet e punës me eproret dhe ja referon atij vetëm në rastet e çështjeve jo të zakonshme.
- 14-Respekton të gjitha rregullat dhe dispozitat ligjore dhe dokumentimin,administrimin dhe ruajtjen e dokumentave që administron apo punon.
- 15-Kryen çdo detyrë tjetër që i caktohet nga përgjegjësi i sektorit gjithmonë në lidhje me fushen e veprimtarisë të sektorit ku bën pjesë.

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

• KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojnë diplomë te nivelit MASTER profesional ose te barasvlefshem , në (shkenca ekonomike) edhe Bachelori duhet të jetë përfunduar në degen e shkencave ekonomike.
- Të ketë eksperiencë pune në profesion jo më pak se 1 vit.
- Të ketë njohuri bazë për programet kompjuterike

• DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Tropojë, dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://administrata.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopjet e diplomës masterit ose te barasvlefshme (përfshirë edhe diplomën bachelor) dhe listen e notave;nëse studimet janë kryer jashte shtetit së bashku me diplomën duhet të përcillet edhe njesimi i diplomes nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Tropojë , brenda datës **29.01.2018**

• **REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **31.01.2018**, njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Tropojë , do të shpallë në stenden e informacionit Bashkise të institucionit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e verifikimit paraprakë të kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).Ndërsa me dt.**08.02.2018** shpallet lista e verifikuar e kandidateve qe kualifikohen në fazen e parë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista

• **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;i ndryshuar
- 3-Kodin e Procedurave Administrative;
- 4-Kodin e Etikes
- 5-Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,
- 6-Ligji 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
- 7-Udhëzimi nr.30 dt.27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik”
- 8-Aktet nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërpërmendur

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar.

Kandidatët do të vlerësohen për pervojen, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al” <http://administrata.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në stenden e informacionit të Bashkisë Tropojë, dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”

2.-PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Këtë informacion do ta merrni në stenden e informacionit të Bashkisë Tropojë , duke filluar nga data **08.02.2018**.

2.1- KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formësë prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomën te nivelit master Profesional ose të barasvlefshëm në shkencat ekonomike(edhe bachelori)duhet të jetë përfunduar në shkencë ekonomike.
- Eksperienca e punës në profesion duhet të jetë të paktën 1 (një) vit

2.2- DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://administrata.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);nëse studimet janë kryer jashtë vendit duhet që të përcillet njëhësi i diplomes nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- Vetëdeklarim që nuk është përjashtuar me masë disiplinore nga sherbimi civil
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen pranë njësisë së Burimeve Njerëzore, Bashkia Tropojë, ose nëpërmjet shërbimit postar.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës **02.02.2018**.

2.3- REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **12.02.2018** Bashkia Tropojë , do të shpallë në Stenden e informacionit Bashkise Tropojë dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e verifikimit paraprake te kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Tropojë, për shkaqet e moskualifikimit si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista (nëpërmjet adresës së e-mail).Ndërsa me dt.**22.02.2018** shpallet lista e verifikuar e kandidateve qe kualifikohen ne fazen paraprake dhe munde të vazhdojne konkurimin.

2.4- FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA E RISTRUKTURUAR ME GOJË

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;i ndryshuar
- 3-Kodin e Procedurave Administrative;
- 4-Ligjin nr. 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore” .

5-Kodin e etikes

6-Ligji 10296 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

7-Udhezimi nr.30 dt.27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik”

8-Aktet nënligjore në zbatim të ligjeve të sipër përmendur

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 -MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al” <http://administrata.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

-Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në portalin e “Shërbimit Kombëtarë i Punësimit ” për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive: për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak, datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi ;

-Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë të cilet nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

-Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin e shërbimit kombëtar të punësimit” dhe Stenden e informacionit Publikut Bashkise Tropojë duke filluar nga data **12.02.2018** e në vazhdim.

Në përfundim të konkurimit Bashkia Tropojë, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, stenden e informacionit publikut Bashkise.

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE